



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 32
Prishtinë, më 29.09.2009 ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 203

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Mark Krasniqi Adem Hajdaraj, Heset Cakolli, Gani Buçinca, Memli Krasniqi dhe Dragan Dimiq.
Mungoi Donika Kadaj-Bujupi.
Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i OSBE-së, NDI-së, përfaqësuesi nga Presidenca përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.
Me kërkesë të anëtarit të Komisionit Arsim Rexhepi në mbledhje prezantuan një delegacion i Universitetit të Bohumit të Gjermanisë.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2009
3. Çështjet aktuale në arsim
4. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Agim Veliu -kryetar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 08.09.2009

2. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2009.

Agim Veliu –kryetar tha se për shkak të ndryshimit të Strategjisë Legjislative nga ana e Qeverisë së Kosovës, Komisioni e ka të domosdoshme edhe ndryshimin e planit të punës së vet të cilin e ka miratu në fillim të vitit. Dinamika e realizimit të planit të punës është varur nga ritmi i ardhjes së projektligjeve nga ana e Qeverisë së Kosovës. Për këtë arsye shqyrtimi i disa projektligjeve, të cilat janë vonuar nga Qeveria, janë shtyrë për shqyrtim për periudhën e dytë të këtij viti.

Pasi që plani i punës së Komisionit ndryshon nga Strategjia Legjislative e plotësuar në muajin gusht, Komisioni është i detyruar të ndryshoi planin e tij të punës, ta plotësojë dhe ndryshojë sipas strategjisë të cilën e ka modifikuar Qeveria e Kosovës.

Në vazhdim kryetari tha se Komisioni iu ka përmbajtur planit të punës me përjashtim të vizitave të parapara jashtë vendit të cilat nuk janë realizuar deri më tani.

Anëtarët e Komisionit përkrahën Strategjinë Legjislative të Qeverisë dhe shpresuan që projektligjet do të arrijnë me kohën e paraparë në mënyrë që të njëjtat të shqyrtohen dhe procedohen deri në fund të këtij viti.

3. Çështjet aktuale në arsim

Agim Veliu –kryetar tha se për këtë pikë e rendit të ditës do të duhet të debatohet pasi të merren informacionet e sakta nga MASHT.

Memli Krasniqi kërkoi sqarim lidhur me të dhënat e kërkuara të Komisionit nga ana e Ministrisë së arsimit.

Kryetari në vijim sqaroi se Komisioni në mbledhjen e kaluar ka debatuar lidhur me çështjen e testit të maturës shtetërore dhe ka kërkuar sqarim nga MASHT-i që të ofrojë Raport me informacione më detajuese.

Komisioni ka debatuar edhe për çështjen e akreditimit të IPAL-së si dhe për rritjen e numrit të studentëve në UP të Prishtinës.

Pasi që Raporti ende nuk ka arritur, ne si Komision këtë çështje do duhej ta debatonim pasi të merret një informacion i plotë.

Arsim Rexhepi kërkoi që Komisioni të debatojë lidhur me uljen e kriterit të kalueshmërisë së provimit të maturës shtetërore nga ana e Ministrisë së arsimit, me këtë rast kërkoi që Ministria t'i përmbahet Ligjit për maturën shtetërore, apo edhe të kërkojë amendamentimin e tij..

Drita Kadriu lidhur me vendimin për uljen e kriterit të kalueshmërisë tha se duhet pritur kohe në mënyrë që të shihen rezultatet e kësaj. Ajo tha se ne duhet të angazhohemi për procesin e zhvillimit të arsimit dhe për rritje të cilësisë së arsimit. Me këtë rast duhet kërkuar informacione nga Këshillat shtetërore të kurrikulave dhe të ndërrmeren masa për rritjen e cilësisë së arsimit e jo të merremi me çështjen e uljes së kriterit të kalueshmërisë.

Memli Krasniqi lidhur me këtë çështje tha se problemet në arsim janë strukturore dhe që duhet të adresohen në mënyrë që arrihet një cilësi në arsim. Lidhur me uljen e kuotës së kalueshmërisë ai tha duhet kërkuar sqarim nga MASHT.

Gani Buçinca mendon se me uljen e kriterit i ipet mundësia e studimit sa më shumë nxënësve, dhe në këtë rast nuk ka ndonjë konflikt interesi. Uljen e kriterit të kalueshmërisë e vlerëson si diskriminim pozitiv që është në dobi të nxënësve dhe këtë çështje e sheh si çështje me interes të qytetarit.

Heset Cakolli tha se në mbledhjen e kaluar i ka ngritur tri çështje, ndër të cilat edhe çështjen e provimit të maturës shtetërore. Ai mendon se për këtë do të duhet debatuar pasi të kemi raport të detajuar lidhur me këto çështje.

Mark Krasniqi mendon se ligjet duhet zbatuar dhe se çfarëdo vendimi që është në kundërshtim me Ligjin është në dëm të qytetarit.

Kryetari konstatoi se me vendimin për uljen e kriterit të kalueshmërisë është shkelur Ligji për Maturën Shtetërore dhe kërkon nga Ministria që të sqarojë bazën ligjore të këtij vendimi.

Lidhur me çështjen e uljes së kriterit të provimit të maturës shtetërore, Komisioni i

Rekomandon

Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të sqarojë bazën ligjore të Vendimit të uljes së pragut të kalueshmërisë të maturës shtetërore nga 50% në 45% dhe të dhënat ti procedohen Komisionit në afat sa me të shpejtë.

4. Të ndryshme.

Mbledhja e ardhshme e Komisionit do të caktohet pas marrjes së informacioneve nga MASHT.

Mbledhja përfundoi në orën 12,05.

Kryetari i Komisionit

Agim Veliu